



KOMUNIKATË PËR SHTYP

28 qershor 2017

KSC9-17

Aktvendim i Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese: Rregullat e Rishikuara në përputhje me Kushtetutën e Kosovës

Sot, Kryetarja e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, gjykatësja An Pauër-Ford, shqiptoi Aktvendimin e Gjykatës mbi Referimin e Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave ('Rregullat e Rishikuara'). Gjykata vlerësoi njëzëri se Rregullat e Rishikuara janë në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ('Kushtetuta').

Më 26 prill 2017, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese konstatoi se nëntë rregulla të Rregullores së Procedurës dhe të Provave ishin në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës dhe për një rregull tjetër nuk mund të nxirre konstatim mbi përputhshmërinë.

Pas këtij vendimi, gjykatësit e tjerë të Dhomave të Specializuara të mbledhur në seancë plenare miratuan Rregullat e Rishikuara. Më 31 maj 2017, Rregullat e Rishikuara iu referuan Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese. Në përputhje me [Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar](#) ('Ligji'), tre gjykatësit kushtetues në përbërje të panelit të Gjykatës Kushtetuese kishin 30 ditë për shqyrtimin e Rregullave të Rishikuara.

Në Aktvendimin e sotëm, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese deklaroi se Referimi ishte i pranueshëm. Ajo kujtoi se sipas Ligjit, Dhomat e Specializuara duhet të gjykojnë dhe funksionojnë në përputhje me Kushtetutën dhe me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Pas shqyrtimit të Rregullave të Rishikuara të miratuara nga Plenarja, Gjykata konstatoi se ato ishin në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

Lidhje:

[Aktvendim](#) (aktualisht vetëm në anglisht)

[Shqiptim i Aktvendimit](#)

Për më shumë informacion në lidhje me Dhomat e Specializuara të Kosovës, vizitoni www.scp-ks.org

KONTAKTI:

Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun e Dhomave të Specializuara, në adresën mediaKSC@scp-ks.org, telefoni: +31(0)6 249 21 03